



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria – Vlada - Government

Ministria e Shëndetësisë - Ministarstvo zdravstva - Ministry of Health
Divizioni i Prokurimit/Divizia Nabavke/Procurement Division

Prishtine datë, 21.07.2025

Zyrtari Përgjegjës i Prokurimit i Ministrisë së Shëndetësisë, në mbështetje të nenit 108/A (paragrafi 10.1) të Ligjit për Prokurimin Publik nr. 04/L-042, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092, duke u bazuar në nenin 63 të Rregullores për Prokurim Publik të aprovuara nga Komisioni Rregullativ i Prokurimit Publik, duke vendosur sipas **kërkesës për ri-shqyrtim** të datës **18.07.2025**, të parashtruar nga **N.T.SH. EUROPA-Bastri Ademi B.I.** lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: **“Servisimi i automjeteve të MSH-se”** me nr. prokurimi 206-25-4944-2-2-1, nxjerr:

V E N D I M

1. **Pranohet**, si e bazuar kërkesa për ri-shqyrtim e OE N.T.SH. EUROPA-Bastri Ademi B.I. e dt. 18.07.2025, lidhur me aktivitetin e prokurimit **“Servisimi i automjeteve të MSH-se”** me nr. prokurimi 206-25-4944-2-2-1, kundër Njoftimit për kontratë të datës 27.06.2025;
2. **Korrigjohet**, Njoftimi për kontratë të datës 27.06.2025;
3. Autoriteti Kontraktues, pas shqyrtimit nga OSHP të një ankese të dërguar sot për këtë lende, do të procedoj me Njoftimin për Korrigjim B54;
4. Ky vendim hyn në fuqi ditën e nënshkrimit dhe do të publikohet për të gjitha palët në platformën elektronike në adresën: <https://e-prokurimi.rks-gov.net>.

A r s y e t i m

OE **N.T.SH. EUROPA-Bastri Ademi B.I.** me datën 18.07.2025, ka parashtruar kërkesë për ri-shqyrtim, lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: **“Servisimi i automjeteve të MSH-se”** me nr. prokurimi 206-25-4944-2-2-1. Autoriteti Kontraktues sot me datë 21.07.2025 e ka shqyrtuar kërkesën në fjalë si më poshtë:

Dispozitat e LPP-së që supozohet të jenë shkelur nga AK sipas OE ankues:

Neni 27

Neni 51 Njoftimi i Kritereve të Përzgjedhjes

Neni 69 Aftësia Teknike dhe/ose Profesionale

Pretendimet ankimore te OE ankues:

N.T.SH. EUROPA-Bastri Ademi B.I. është e interesuar që të marrë pjesë në tenderin e organizuar nga **MINISTRIA E SHËNDETËSISË** me numer të prokurimit : **206-25-4944-2-2-1 me titull “Servisimi i automjeteve te MSH-se”** Sa i përketë këtij aktiviteti të prokurimit ne kemi përcjelluar nga fillimi rrjedhen e këtij aktiviteti të prokurimit.

Duke marrë parasysh që ka pasur Kërkesë Për Rishqyrtim nga një OE konsiderojm që AK-ja ka vepruar në mënyrë jo profesionale duke e korigjuar dosjen e tenderit duke i aprovuar disa pretendime ankimore të cilat kanë qenë jo profesionale.

PRETENDIM ANKIMORE

Në Listen e cmimeve Autoriteti Kontraktues ka vendos disa lloje të veturave të cilat duhet servisuar dhe mirëmbajtur. Një nga to p.sh. është vetura **BMW 730 Ld xDrive Viti 2015 automatik** e cila veturë nuk mund të diagnostifikohet me qfar do lloj diagnoze.

Në dosjen e tenderit dhe në njoftimin për kontratë fillimisht ka qenë kërkesa kësisoj:

III.2.4) Kapaciteti teknik dhe profesional:

3. Operatori Ekonomik duhet te posedoj mjetet, stabilimentet dhe pajisjet teknike qe janë te domosdoshme për realizimin e kontratës a.

Vinça Hidraulik për ngritje te automjeteve minimum 5 b. Pajisje e klimave, për mbushje me gaz 1234 YF) për modele te reja te veturave c .Pajisje për mbushjen e klimave (mbushje me gaz 134 A d. Pajisje për diagnostikimin e automjeteve për Mercedes benz C4 plus origjinal dh. **Diagnoza BMW ISTA+ e. Pajisje diagnoza origjinalë për Peugeot (DIAGBOX) ë. Pajisje diagnostifikime për WV, Shkoda, Audi, Seat - Odis (VNCI 6154 A) f. Automjet për transportimin e automjeteve g. Pajisje për vullkanizim dhe ballansim te gomave.**

3. Pajisjet duhet te dëshmohen me foto apo ndonjë dokument tjetër dëshmues te pronësisë (apo marrëveshje për marrjen me qira). - Për pikat a,b,g te dëshmohen me Deklarata unike doganore – DUD apo fatura për blerjen e tyre. - Për pikat c, d, dh, e, ë te dëshmohen me Foto te pajisjeve. - Për automjetet qe janë ne lëvizje për bartjen e automjeteve ato te dëshmohen me libreza te qarkullimit te automjeteve valide.

Fillimisht Autoriteti Kontraktues ka vendos disa kriteret të cilat kanë qenë profesionale dhe të cilat ju përgjigjen nevojave dhe kërkesave të AK-së për rregullim dhe mirëmbajtjen e veturave dhe diagnostifikimin e tyre për secillin lloj të veturave të cilat gjinden në listen e cmimeve të AK-së.

Pas korigjimit të dosjes së tenderit nga AK-ja më 17.07.2025 AK-ja ka paraparë këto kriteret:

Kapaciteti teknik dhe professional:

3. Operatori Ekonomik duhet te posedoj mjetet, stabilimentet dhe pajisjet teknike qe janë te domosdoshme për realizimin e kontratës:

- a. Vinça Hidraulik për ngritje te automjeteve minimum 5
- b. Pajisje e klimave, për mbushje me gaz 1234 YF) për modele te reja te veturave
- c .Pajisje për mbushjen e klimave (mbushje me gaz 134 A
- d. Pajisje speciale kompjuterike për diagnostifikimin e defekteve të automjeteve.**
- f. Automjet për transportimin e automjeteve
- g. Pajisje për vullkanizim dhe ballansim te gomave.

Siq vërehet AK-ja ka vendos ti largoj disa kritere (diagnoza) të cilat drejtpërdrejt ndikojn në cilësin, shpejtësin dhe rregullimit të veturave.P.sh. vetures **BMW 730 Ld xDrive Viti 2015 automatik** nuk mund që ti bëhet diagnozifikimi me qfar do lloj diagnoza.

Autoriteti Kontraktues në piken d. ka kërkuar **d. Pajisje speciale kompjuterike për diagnostifikimin e defekteve të automjeteve.** Pa specifikuar qfar diagnoze.Vetura **BMW 730 Ld xDrive Viti 2015 automatik** është lloj i vetures e cila kërkon diagnoz të veqant pra veq për BMW dhe jo diagnoza te veturave tjera apo universale.

Andaj kërkojm që së paku diagnoza e vetures BMW e cila ka qenë fillimisht në Njoftimin për Kontratë dhe në dosjen e tenderit të jetë pjesë e dosjes së tenderit.

Kërkojmë nga AK-ja që ta aprovon Kërkesën Për Rishqyrtim dhe ta korrigjoj dosjen e tenderit.

Dëmet materiale - Mund të jenë të konsiderueshme

Përgjigjet e Autoritetit Kontraktues ne lidhje me pretendimet ankimore:

E kemi shqyrtuar kërkesën tuaj për rishqyrtim dhe mund te konstatojmë se pretendimi juaj ankimore eshte i bazuar dhe si i tille merret parasysh nga AK për korrigjim.

Pranohet Pretendimi juaj ankimor, ne lidhje me veturën BMW 730 Ld xDrive Viti 2015 automatik


Korrigjohet kërkesa nr. 3 e DT, te Kapaciteti mbi mundësitë teknik dhe profesional 9.1 & 9.2 duke u shtuar diagnoza per BMW: **Diagnoza BMW ISTA+**

Sqarim: Sot eshte deponuar një ankese ne OSHP, andaj duhet ta pezullojmë lenden, ndërsa pas shqyrtimit nga OSHP te ankesës ne fjale, do te procedojmë me Njoftimin për Korrigjim B54 duke e përfshirë edhe këtë pike – shtimin e Diagnoza BMW ISTA+

Zyrtari Përgjegjës i prokurimit bazuar ne ato që u thane më lart ka vendosur si ne dispozitiv.

Këshilla juridike:

Kundër këtij vendimi, ankuesi mund të paraqesë ankesë pranë OSHP-së. **Ankesa pranë OSHP-se duhet te dorëzohet brenda 10 (dhjete) ditëve pas pranimit te këtij vendimi.**



Berat Marmullaku

Zyrtari përgjegjës i Prokurimit